



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.177/2022

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINE– Dhoma e Shkallës se Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit S... nga Prishtina të cilin e përfaqëson me autorizim Ekrem Egushi avokat nga Prishtina kundër të paditurit Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulimi i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1535/13 i datës 12.03.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.10.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit S... nga Prishtina e datës 16.05.2019, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, A.nr.1535/2013 i datës 12.03.2019, PRISHET, dhe lënda i kthehet Departamentit për çështje administrative i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në rigjykim dhe rivendosje

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit S... nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar nga gjykata anulimin e vendimit të paditurit Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës në Prishtinë, nr.ref.kont.PK..... Furnizim me automjete Llot 2, datë 07.11.2013.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka ushtruar ankesë, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të miratohet si e bazuar ndërsa i padituri të detyrohet që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës administrative në shumën prej 642.00€ ose aktgjykimi ankimor të prishet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës administrative të cilat shprehen në faktin se seanca e shqyrtimit përgatitor nga gjykata e shkallës së parë është mbajtur në mungesë të autorizuarit të paditësit, e në prani të K.A. i cili mbi bazën e autorizimit zëvendësues ka pasur tagër që të ndërmarr veprime procedurale vetëm në seancën e shqyrtimit përgatitor, e kurrsesi në seancën e shqyrtimit kryesor, sikundër ka vepruar gabimisht gjykata e shkallës së parë e cila shqyrtimin kryesor e ka mbajtur pa praninë e të autorizuarit të paditësit, me të cilin veprim jo ligjor paditësit i është pamundësuar pjesëmarrja në shqyrtimin kryesor. Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur në prani të zëvendësuesit të autorizuarit të paditësit, i cili nuk ka poseduar autorizim për përfaqësim por vetëm zëvendësim në seancë për

shqyrtim përgatitor, e që në këtë rast gjykata ka bërë shkelje qenësore nga dispozitat e nenit 35 al.2 të LPPA-së dhe nenit 63 të LKA-se e lidhur me nenin 90 al.4 të LPK-se. Shkeljet e dispozitave të procedurës administrative dhe vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike janë rrjedhojë se gjykata e shkallës së parë nuk mund të vlerësoj ligjshmërinë e aktvendimit kontestues sepse kemi të bëjmë me zgjidhje të njëanshme të kontratës kontestuese e lidhur mes palëve kontraktuese, dhe zgjidhja e kontratës mund të bëhet me vullnetin e palëve dhe përmes gjykatës në procedurë kontestimore e jo në procedurë administrative.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 13 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin ankimor, e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës në Prishtinë, nr.ref.kont.PK.... Furnizim me automjete Llot 2, datë 07.11.2013, ka ndërprerë njëanshëm kontratën nr.ref.PK....., si autoritet furnizues, nuk iu ka përmbajtur kushteve të kësaj kontrate të lidhur me autoritetin kontraktues në aspektin e mirëmbajtjes dhe servisimit nën garancion të 9 automjeteve për periudhën kohore 3 vjeçare.

Kundër këtij vendimi administrativ përfundimtar të nxjerr nga organi administrativ, paditësi me padi inicon konflikt administrativ në procedurë gjyqësore, ndërsa Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 12.03.2019, të mbajtur në prani të zëvendësuesit të autorizuarit të palës paditëse e në mungesë të përfaqësueses së autorizuar të palës së paditur e cila ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bie Aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit. Në arsyetim ndër të tjera gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, është referuar në obligimet kontraktuese mes palëve ndërgjyqëse të përcaktuara me Kontratën e furnizimit me automjete Llot2 nr. dt.08.08.2013, dhe nga gjendja faktike që ka rezultuar pas disa komunikimeve mes palëve kontraktuese në mos përmbushjen e obligimeve nga pala paditëse, e cila ishte e njoftuar për pasojat e mos përmbushjes së tyre, në bazë të dispozitave të kontratës, gjykata e konsideron të drejt vendimin e të paditurës me të cilin ka ndërprerë njëanshëm kontratën me paditësin.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 63 i LKA-së, e lidhur me nenin 182 par.2 të LPK pika (k) e cila përcakton se:

në qoftë se në procedurë si paditës, ose i paditur, ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedurës apo për kryerjen e ndonjë veprimi në procedurë, në qoftë se zhvillimi i procedurës, respektivisht ushtrimi i veprimeve të veçanta në procedurë nuk është lejuar më vonë.

Pretendimet ankimore të paditësit të theksuara si më lartë si dhe theksimet e tjera si në arsyetim të ankesës, Kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se janë të bazuara dhe qëndrueshme, bazuar në faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes së kësaj çështje administrative, ka gjykuar rastin konkret duke mbajtur seancën gjyqësore me datë 12.03.2019, në prani të personit K.A., cili në këtë rast ka prezantuar para gjykatës autorizimin zëvendësues dt.11.03.2019, me të cilin i njëjti është autorizuar ta zëvendësoj të autorizuarin-avokatin e palës paditëse, vetëm në seancën e shqyrtimit përgatitor që do të mbahet me datë 12.03.2019 në gjykatë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të seancës gjyqësore, ka pasur për detyrë që të kujdeset se personi K.A. i cili është prezantuar si zëvendësues i autorizuesit të palës paditëse, deri në çfarë vëllimi të autorizimit ka pasur të drejt ta përfaqësoj të autorizuarin E.A., i autorizuari i palës paditëse. Kolegji, nga shkresat e lëndës ka konstatuar se Autorizimi zëvendësues i datës 11.03.2019 përfshin veprime të caktuara të zëvendësimit vetëm për seancën e shqyrtimit përgatitor dt.12.03.2019, ndërsa gjykata e shkallës së parë ka udhëhequr procedurë në konflikt administrativ duke mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë të njëjtë 12.03.2019, ka administruar provat e e lëndës dhe në fund ka mbyllur seancën e shqyrtimit kryesor të konstatuar në procesverbal të seancës kryesore, në prani të personit K.A. bashkëpunëtor-jurist në zyrën e av E.A..

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke vlerësuar procedurën e zhvilluar në konflikt administrativ, konstaton se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 93.4 dhe 86.2 të LPK-së ku përcaktohet se:

gjykata ka për detyrë që gjatë gjithë procedurës të kujdeset nëse personi që prezantohet si përfaqësues është i autorizuar për përfaqësim.
veprimet në procedurë të cilat i kryen përfaqësuesi i palës brenda kufijve të autorizimit kanë efekte juridike sikur t'i ketë kryer vetë pala,

Kolegji, vlerëson se zëvendësuesi i autorizuesit të palës paditëse, i cili ka marr pjesë në seancën kryesore, nuk ka pasur autorizim që të përfaqësoj të autorizuarin e as palën paditëse, deri në përfundim të kësaj çështje, por vetëm në seancën e shqyrtimit përgatitor.

Prandaj, Kolegji, aprovoi pretendimet ankimore në drejtim të përfaqësimit ligjor të palës paditëse në seancën gjyqësore të mbajtur pranë gjykatës së shkallës së parë, dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, të caktojë seancën gjyqësore, duke ftuar përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse, ashtu që obligohet të kujdeset gjatë gjithë procedurës në konflikt administrativ, të verifikoj vërtetësin e vëllimit të prokurës-autorizimit nga personat që përfaqësojnë palët ndërgjyqëse në konflikt administrativ, dhe të vendos çështjen në bazë të dispozitave ligjore në fuqi dhe provave të administruara në procedurë të konfliktit administrativ.

Për arsyet e lartë cekura, aktgjykimi i kundërshtuar është dashtë të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për t'i mënjanuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të theksuara më lartë, e që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur. Në ri-procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet ti mënjanoj të metat e vërejtura sipas këtij aktgjykimi, dhe pas mënjanimit të tyre, ka mundësi të bie aktgjykim të drejt dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 13 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, si dhe nenit 195 par.1 pika (c), të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.177/2022 datë 06.10.2022

Kryetari i kolegjit-gjyqtari

Krenar Berisha